



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

---

**V E N D I M**

**Nr. 21 datë 20.11.2019**

**“PËR SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të dates 20.11.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, nenit 55, pika 3, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar ; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ; pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr. 1, datë 17.1.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, Udhëzimit nr. 8, datë 17.2.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donator të huaj”; Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017; Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, nënshkruar më 24 tetor 2016 ; Marrëveshja standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë së Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës”, me nr. 18249 Prot, datë 25.10.2019 ; VKB nr. 82 datë 20.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar ; Relacionit të administratës së Bashkisë Shkoder nr.4356/b, date 13.11.2019.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektin “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës”, financiar në kuadër të programit “Leave No One Behind (LNB) – “Askush të mos mbetet”, si pjesë e aktivitetit 1.2.4 “Mbështetje për

projektet për shërbime të reja inovative në nivel lokal”, udhëhequr dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri – *UNDP Albania*, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për të mbështetur projekte në fushën e shërbimeve shoqërore me bazë komunitare të propozuara nga çdo bashki në Shqipëri, në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, shuma 1,999,140 Lekë.

Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:			
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale
Shuma 2020	1,999,140	811,002	135.438	957,700	95,000
Shuma totale e Projektit e financuar nga programi	1,999,140	811,002	135.438	957,700	95,000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

**Sekretar i Këshillit**

  
Denis Lesha

**KRYETARE**

  
Brigola KADIJA

